

**VENDIM**  
**Nr. 752, datë 26.10.2016**

**PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUSIT, NGA TOKË BUJQËSORE NË TOKË TRUALL PËR NDËRTIM, PËR SIPËRFAQET QË PRITEN TË NDIKOHEN NGA NDËRTIMI I SEKSIONIT TOKËSOR TË GAZSJELLËSIT TRANS ADRIATIK (PROJEKTI TAP), SEKTORËT 4A, 4B DHE 5A, PËR PESË STACIONE TË VALVULAVE TË SIGURISË/BLLOKIMIT, TË CILAT DO TË VIHEN NË DISPOZICION TË SHOQËRISË TRANS ADRIATIK PIPELINE AG (TAP AG) PËR PËRDORIM TË PËRHERSHËM**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar, të ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, si dhe të ligjit nr. 116/2013, “Për ratifikimin e marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave dhe Trans Adriatik Pipeline AG, lidhur me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP) dhe të marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave dhe Trans Adriatik Pipeline AG, në lidhje me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP)”, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e ndryshimit të statusit të tokës bujqësore dhe kalimin në tokë truall për parcelat me sipërfaqe të përgjithshme prej 5 457,67 (pesë mijë e katërqind e pesëdhjetë e shtatë presje gjashtëdhjetë e shtatë) m<sup>2</sup>, të cilat ndikohen nga ndërtimi i 5 (pesë) stacioneve të valvulave të sigurisë/bllokimit të seksionit tokësor të Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP), përkatësisht:

a) në sektorin 4A, për dy stacione në qarkun e Korçës:

i) Stacioni i valvulave të sigurisë/bllokimit ABV24, në Cangonj, me sipërfaqe të tokës bujqësore prej 1 099,76 (një mijë e nëntëdhjetë e nëntë presje shtatëdhjetë e gjashtë) m<sup>2</sup>;

ii) Stacioni i valvulave të sigurisë/bllokimit ABV25, në Polenë, me sipërfaqe të tokës bujqësore prej 1 099,76 (një mijë e nëntëdhjetë e nëntë presje shtatëdhjetë e gjashtë) m<sup>2</sup>.

b) në sektorin 5A, për stacionin e valvulave të sigurisë/bllokimit ABV26, në Shtyllë, në qarkun e Korçës, me sipërfaqe të tokës bujqësore prej 1 099,75 (një mijë e nëntëdhjetë e nëntë presje shtatëdhjetë e pesë) m<sup>2</sup>;

c) në sektorin 4B, për dy stacione, në qarkun e Beratit dhe në qarkun e Fierit:

i) Stacioni i valvulave të sigurisë/bllokimit ABV30, në Pashalli/Ura Vajgurore, qarku Berat, me sipërfaqe të tokës bujqësore prej 1 058,65 (një mijë e pesëdhjetë e tetë presje gjashtëdhjetë e pesë) m<sup>2</sup>;

ii) Stacioni i valvulave të sigurisë/bllokimit ABV31, në Roskovec, qarku Fier, me sipërfaqe të tokës bujqësore prej 1 099,75 (një mijë e nëntëdhjetë e nëntë presje shtatëdhjetë e pesë) m<sup>2</sup>.

2. Sipërfaqet e tokës, që do të ndikohen nga ndërtimi i stacioneve të valvulave bllokuese të seksionit tokësor të Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP), do të vihen në dispozicion të shoqërisë Trans Adriatik Pipeline AG (TAP AG) për përdorim të përhershëm.

Parcelat që ndryshojnë statusin, nga tokë bujqësore në tokë truall, për pesë stacionet e valvulave të sigurisë/bllokimit të seksionit tokësor të Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP), jepen në lidhjen 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, drejtoritë e administrimit dhe menaxhimit të tokës së qarqeve Fier, Berat dhe Korçë të pasqyrojnë në dokumentacionin kadastral përkatës ndryshimet e kategorisë së resurseve, nga tokë bujqësore në tokë urbane (truall), respektivisht për secilën parcelë, për pesë stacionet e valvulave të sigurisë/bllokimit të projektit TAP, sipas lidhjes 1, të këtij vendimi.

4. Procedurat për zgjidhjen e marrëdhënieve të pronësisë, ndërmjet kompanisë TAP AG dhe pronarëve aktualë të këtyre parcelave, me qëllim marrjen e lejeve të nevojshme për ndërtimin dhe operimin e rrjetit të rrugëve të kalimit (ndihmëse) për projektin TAP, sipas kërkesave të ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, do të bëhen në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 116/2013, “Për ratifikimin e marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave dhe Trans Adriatik Pipeline AG, lidhur me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP) dhe të marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave dhe Trans Adriatik Pipeline AG, në lidhje me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP)”, si dhe gjithë legjislacionit tjetër në fuqi për marrëdhëniet e pronësisë mbi tokën.

5. Shoqëria TAP AG dhe Ministria e Energjisë dhe Industrisë, në bashkëpunim me Zyrën Qendrore të

Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, si dhe të vendimit nr. 245, datë 30.4.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kushteve dhe të procedurave për përmirësimin e përditësimin e të dhënave të regjistrit të pasurive të paluajtshme”, të bëjnë ndryshimet në regjistrat dhe kartelat e pasurisë/ive përkatëse, për sa u përket marrëdhënieve të pronësisë, për parcelat që do të ndikohen nga ndërtimi i seksionit tokësor të Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP), përkatësisht sektorët 4A, 4B dhe 5A, për pesë stacionet e valvulave të sigurisë/bllokimit, të cilave do t’u ndryshohet statusi nga tokë bujqësore në tokë truall.

6. Shoqëria TAP AG, pas përfundimit të punimeve për ndërtimin e seksionit tokësor të Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP), përkatësisht sektorët 4A, 4B dhe 5A, për pesë stacionet e valvulave të sigurisë/bllokimit, është e detyruar të realizojë rehabilitimin mjedisor të territorit në ato pjesë të parcelave që janë ndikuar nga ndërtimi i këtyre stacioneve, por që nuk do të përfshihen si pjesë e stacioneve.

7. Ngarkohen Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qarqet Korçë, Berat dhe Fier për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

**Niko Peleshi**

**Lidhja 1**

**SIPËRFAQET TOKË BUJQËSORE TË IMPAKTUARA NGA SEKSIONI TOKËSOR I  
PROJEKTTIT TAP - SEKTORI 4A, SEKTORI 5A DHE SEKTORI 4B  
(Stacionet e Valvulave të Bllokimit - ABV24, ABV25, ABV26, ABV30, ABV31)**

| Emri i SVS/B       | Qarku           | Zona kadastrale | Emri     | Parcela | Statusi i parcelës | Përdorimi      | Sipërfaqja | Sipërfaqja e prekur/ndikuar (m <sup>2</sup> ) |
|--------------------|-----------------|-----------------|----------|---------|--------------------|----------------|------------|-----------------------------------------------|
| ABV24              | DEVOLL          | 1355            | Cangonj  | 40/22   | private            | TOKË BUJQËSORE | 4,828.79   | 63.26                                         |
| ABV24              | DEVOLL          | 1355            | Cangonj  | 40/23   | private            | TOKË BUJQËSORE | 3,594.44   | 782.64                                        |
| ABV24              | DEVOLL          | 1355            | Cangonj  | 40/37   | private            | TOKË BUJQËSORE | 8,126.03   | 253.86                                        |
| <b>Shuma ABV24</b> | <b>1099.76</b>  |                 |          |         |                    |                |            |                                               |
| ABV25              | KORÇA           | 3016            | Polenë   | 69/15   | private            | TOKË BUJQËSORE | 2,482.55   | 192.06                                        |
| ABV25              | KORÇA           | 3016            | Polenë   | 69/16   | private            | TOKË BUJQËSORE | 1,931.90   | 350.27                                        |
| ABV25              | KORÇA           | 3016            | Polenë   | 69/17   | private            | TOKË BUJQËSORE | 1,376.57   | 256.5                                         |
| ABV25              | KORÇA           | 3016            | Polenë   | 69/18   | private            | TOKË BUJQËSORE | 1,095.61   | 197.87                                        |
| ABV25              | KORÇA           | 3016            | Polenë   | 69/19   | private            | TOKË BUJQËSORE | 1,937.09   | 103.06                                        |
| <b>Shuma ABV25</b> | <b>1099.76</b>  |                 |          |         |                    |                |            |                                               |
| ABV26              | KORÇA           | 3437            | Shtyllë  | 304/4   | private            | TOKË BUJQËSORE | 4,841.52   | 876.47                                        |
| ABV26              | KORÇA           | 3437            | Shtyllë  | 304/5   | private            | TOKË BUJQËSORE | 4,053.36   | 223.28                                        |
| <b>Shuma ABV26</b> | <b>1099.75</b>  |                 |          |         |                    |                |            |                                               |
| ABV30              | BERAT           | 2881            | Pashalli | 440/4   | private            | TOKË BUJQËSORE | 10,033.14  | 1,058.65                                      |
| <b>Shuma ABV30</b> | <b>1,058.65</b> |                 |          |         |                    |                |            |                                               |
| ABV31              | FIER            | 3196            | Roskovec | 10/1    | private            | TOKË BUJQËSORE | 12,931.11  | 1,099.75                                      |
| <b>Shuma ABV31</b> | <b>1,099.75</b> |                 |          |         |                    |                |            |                                               |
| <b>SHUMA</b>       | <b>5,457.67</b> |                 |          |         |                    |                |            |                                               |

